

Poezia-Arti krijues i fjalës

Që nga cikli "Zgjedhimi i foljes", "Tingujt e shpirtit", "Aromë nga lëndina e yjeve", "Njeriu dhe mërgimi" e deri tek ai i funit "Paqe e përflakur" Hysen Ymeri pikturon për ne një mozaik të përflakur poetik, një natyrë të jashtme që është hapturazi në luftë me natyrën e brendshme të tij si poet, një varg formulash dhënë popullit kosovarë, të cilat janë krejtësisht të papërshtatshme për të zgjidhur problemet e mëdha me të cilat janë ballafaquar

Nga Gjekë Marinaj

Ralf Ualldo Emerson (Ralph Waldo Emerson), gjatë një leksioni të mbajtur në Manhattan në 1842, ka pasë theksuar se "poetët janë perëndi çlirimtare". Shpallja frymëzuese dhe largpamëse e tij është kthyer në një kredo ndaj poetëve gjatë gjithë atij segmenti kohor, duke prekur edhe pikat më të skajshme të zonave banuese të globit.

Unë thënie e tij e kuptoj si një shumëkëndësh filozofik. Poetët kanë dhe kanë patur role të ndryshme nga shoqëri gjatë egzistencës njerëzore. Parë nga ky pozicion, edhe zëri poetik i poetit të ri kosovarë Hysen Ymeri, ka të bëjë diçka me mendimin e zotit Emerson. Libri i parë i Ymerit, "Legjenda të humbura", të shqyrtë të mendosh se poeti e ka ndër tërëllë përgjegjësinë e tij si poet.

Le të referohemi tek poezia me titull "Fjala" (faqe 66), nëpërmes të së cilës mund të dallojmë barometrin matës të pulsit të Ymerit në poezinë e tij. Vargjet e mëposhtme janë të shkëputura nga pika kulminante e trupit të poezisë:

Fjala ka fuqinë e një shënjeti
Kur bekimi përkëdhelë në pëllëmbë
Metamorfozën e njeriut të humbur.

Nuk ka rëndësi nëse në vargjet e mësipërme kemi të bëjmë me nevojën e poetit për çlirim dhe dashuri nga dhembja, të shpirtit nga fryerjet, të poezisë për tek fleta e bardhë apo të Kosovës nga pushimi Serb. Ajo që është e rëndësishme të kuptojmë është se poetët humbin dhe fitojnë diçka me humbjet dhe fitimet e popullit që i përkasin. Këtu kemi të bëjmë me një realitet ku efektet anësore të njerëzve janë të paevitueshme për poetët.

Që nga cikli "Zgjedhimi i foljes", "Tingujt e shpirtit", "Aromë nga lëndina e yjeve", "Njeriu dhe mërgimi" e deri tek ai i funit "Paqe e përflakur" Hysen Ymeri pikturon për ne një mozaik të përflakur poetik, një natyrë të jashtme që është hapturazi në luftë me natyrën e brendshme të tij si poet, një varg formulash dhënë popullit kosovarë, të cilat janë krejtësisht të papërshtatshme për të zgjidhur problemet e mëdha me të cilat janë ballafaquar. Ai na fton tek trazirat e shpirtit të tij, duke nga dhuruar librin "Legjenda të humbura" që aty të shohim të

eksponuar realitetin e hidhur që ka jetuar Kosova. Ja ca vargje nga poezia "Këngë e padëgjuar" (faqe 55):

Lumenjtë e kohës
Kanë plagë në faqe dhe ballë:
Iriu duket si plak,
Plaku s' duket të jetë i gjallë...

Në vetëm katër vargje poeti kondenson përmbajtjen e një jete që do të kërkonte faqe të tëra po të ishte realizuar në prozë. Ska se si të shpjegohen ndryshe ndjenjat, vizioni për jetën, ecenca njerëzore apo çrregullimet e herë-herëshme psikologjike që gjejmë tek poezi të tilla, të cilat nuk janë të pakta te "Legjenda të humbura". Janë vështirësitë jetësore që ka kaluar populli kosovar, veçanërisht këtyre dy dekadave të fundit, e kanë kthyer Ymerin në një dimension energjik poetik.

Padyshim, poeti Hysen Ymeri është i njohur me faktin që poezia - arti krijues i fjalës, përmbanë në vetvete çdo gjë që mund të imagjinojmë, prezantuar literaturisht në nuanca piktoriale ose muzikale. Kjo do të thotë, që detyra e tij në daljen me librin e parë s' ka qenë aq e lehtë. Kështu, në punën e këtij poeti, lexuesi do të gjejë më tepër domethënie për të zbuluar, se sa gjuha e përditshme mund të afrojnë. Pikërisht këtu qëndron edhe forca e rezatimit poetik të poetit. Në poezinë që vijon, pagëzuar me emrin "Peri i jetës" (faqe 62), Ymeri na afron ide komplekse, duke u shmangur ëmbëlsisht nga bazamenti i gjuhës që flasim:

Në lamshin e jetës së njeriut
Koha lidhë e zgjidhë nyje.

Trajtuar në një stil dhe këndvështrim tjetër, poezia që pason, "Nuk kam ikur nga ty atdhe" (faqe 25) na shtynë drejt të njëjtit perceptim ideo-artistik. Ndryshimi midis këtyre poezive është një vijë e hollë e hequr nga poeti midis mendimit në poezinë e mësipërme dhe të ndjenjës në poezinë e mëposhtme. Poeti, duke u ikur me sukses mangësive (here-herë) të natyrshme të fillestarëve, i poetizon me ngjyra dhe efekte specifike shqetësimet personale e kombëtare. Duke e parë Kosovën si një pëllumb gjysmë të ngritur nga flakët e luftës, poeti në fjalë i drejtohet qiellit kombëtar, me shpresën se aty do të gjendet pak diell për secilin që ngre sytë drejt tij:

Do të kthehem tek lisi i babës plak

Në shtratin e thekrës për të fjetur;
Vetëm aty ndjehem i gjallë,
Ndonëse mbi të bie si i vdekur...

Që poezinë e tij ta paraqesin plotësisht si representuese të artit, Hysen Ymeri është munduar ta lartësojë mendimin në një status të veçantë. Në vazhdim, lexuesi i vemëndshëm mund të përfitojë kënaqësi edhe nga shkathhtësia e poetit për të integruar në vargje atë zemërim evident që vihet re te njerëzit e sotëm, me domosdoshmerinë për eliminimin e vleracionit hakëmarës ndaj kohës. Prandaj edhe shpresoj që poezidashësit, pasi të kenë mbaruar së lexuari këtë libër, do të jenë në gjendje të pohojnë, që poeti ka arritur ta pikturojë objektin e tentuar, kur është fjala për imazhin, për ngjyrat shpjeguese dhe madhështinë prekëse të sekretit të poezisë. Një prej shumë poezive të tilla është edhe "Bjeshka ime ka dyfaqë"

Bjeshka ime
Ka dy faqe
Njëra me shkëmbinjë
Tjetra me livadhe.
Në faqen e lindjes
Dëgjoj erë shkume
Në atë të perëndimit
Tingëllojnë zëra lufte.

Distopia në poezi, për Hysen Ymerin është diçka më interesante se ç'na afron llogaria e botës imagjinitive. Kulminacionet intensive të moskënaqësisë që zakonisht i referohen të tanishmes dhe jo të ardhmes, ndryshojnë gjithçka në perceptimin e poetit ndaj botës së huaj dhe lidhjeve të saj me faktorin shqiptar. I detyruar të jetonte për një kohë të shkurtër në Austri, dhe i dedikuar të kthehet te vendi i tij i lindjes sa më parë, në poezinë "Lajm për nënën" (faqe 50) poeti shprehet kështu:

Për kthimin tim tek atdheu dhe varret
e të dashurëve
Pranë hënës së lodhur të shtatorit jam betuar:
Edhe në qoftë se e ardhmja ime krejtësisht do të soset
Hirin e trupit tim, vetëm era e Kosovës
ka për ta trazuar.

Nisur nga trajta e lëndës që gjejmë në këtë libër, bindemi se poeti është rritur në një ambient shoqëror të joster-alizuar sa duhet. Turbullirat në të cilat

ka përjetuar ai, apo ndotja sociale, nëse mund të shprehemi kështu, ia kanë imponuar poetit melankolinë (nganjëhere deri në pesimitet) në poezi: Mos më pyet për zërin e tmerrshëm të ëndërrave
Ti digjesh e vetme në zjarrin e algët
Zemrën tënde s'e do askush
Përfshirë këtu Zotin dhe djallin! (nga poezia "Lotët e ikonës, faqe 9)

Në poezinë e Ymerit vemë re edhe një dukuri tjetër: formulat me të cilat autori prezanton argumentet poetike funksionojnë logjikisht dhe të pakomplikuar. Në poezi të tilla, ku shumë poet të rinj hasin vështirësi në përvetësimin e mjeshtërisë së domosdoshme që kërkon stili i silogizmit në vargun poetik, mund të themi se Ymeri triumfon me sukses.

Nga plastika, poezia e Ymerit paraqitet sentimentale, e pasur në domethënie, e stolisur artistikisht dhe relativisht e lehtë për t'u kuptuar për lexuesin. Fatmirësisht, fjalët e tij poetike mund të vijohen në këndvështrime të ndryshme; afërsisht ashtu siç tingëllojnë ose si tingëllima që signifikojnë ide të mëtejshme. Vargjet e mëposhtme i shkëputa nga poezia "Shpirti yt pas vdekjes" (faqe 24):

Atë natë
Ti theve gurët e varreve
Sa vet bjeshkët e Pejës u vranë
Si harqe të zeza vetullash...
Shpirti yt pas vdekjes — britmë e trishtë...

Nuancat poetike në "Legjenda të humbura" poeti mundohet t'i paraqesë në ekuilibër me baticat dhe zbatcat e mendimit; aty ku poezia bie nga pesha artistikisht ai ben ç'është e mundur ta

kompensoi atë me një ngritje të menjëhershme të nivelit të mendimit në varg. Një gjë të tillë ia e bën edhe tek poezia "Jeta" (faqe 63)
Edhe këtë gjysmën e jetës
Që kaq larg vetes jetoj
Një ditë
Do e bashkoj me gjysmën tjetër;
Me atë gjysmën time të panjohur
Që herë më mungon
Herë i mungoj...

Nga mënyra se si i shpreh idetë që gjejmë në poezinë e këtij poeti të ri nga Klina si dhe nga individualiteti krijues që përpiqet t'na afroji, ne lexuesit e ri të tij, mbetemi me përshtypjen se ai ka një stil tërheqës. Ai nuk e humbet në labirinte misterioze lexuesin, por mundohet ta gjejë dhe rigjëjë, ta takoi në gjysmë të udhës në çdo varg atë. Poezia "Babai" është padyshim një shembull i mirë për të ilustruar këtë mendim:

Babai im
Me mundin e vet
Shenoi emrin e tij në farën e vogël të grurit.
Ai e dinte se buka e huaj s'të mban...
Ndaj me bardhësinë e bukës mati barthësinë e fytyrës.

Natyrish, pa mohuar faktin se të gjithë në ushqejmë opinionet tona të ndryshme se si fjala poetike duhet të shprehet, për mendimin tim, Hysen Ymeri vetëm shton dinjitet tek poezia e sotme Kosovare në shumë pikëpamje. Poezia e tij që në gjendje t'na ngrejë gjendjen shpirtërore, si dhe t'na bëjë të mundur gjetjen e vetvës në universalizmin fantastik të saj. Vargjet e tij, here trishtuese e herë ngacmuese, mundën t'na ushqejnë preferencën

**TELEFONONI VENDLINDJËN ME NE
AGJENCIA... "MEMEDHE"**

Me çmimet nga më konkurruese dhe lidhje shumë të mirë

<p>Mali i Zi 9.9 c/min</p> <p>Kosova 19.9 c/min</p> <p>Monako cell 14.9 c/min</p> <p>Macedonia 21.9 c/min</p> <p>Tirana</p> <p>e hënë e martë e mërkurë 14.9 c/min</p> <p>e enjte e premte e shtunë e diel 19.9 c/min</p> <p>Greqia Reg phone 13.9 c/min Athina 8.9 c/min Celular 14.9c/min</p>	<p>Monthly fee - zero State - to - State 5.9c/min Taksat nga më të ultat</p> <p>Kontaktioni në numrat: 1-877 MEMEDHE ose 1877 - 636 - 3343 1249 - 435 - 3686</p> <p>Behar Lumani</p>
---	---

BISERA'S TRAVEL

Bileta udhëtimi me çmime të volitshme për në Vendlindje me aviokompanitë më të njohura amerikane dhe botërore!

Çmime të volitshme, nga New Yorku, Detroiti, Bostoni, Chicago, Los Angelos, San Francisco për në Podgoricë, Tiranë, Prishtinë, Shkup etj....

Bisera Gjokaj

49 WEST 39 STREET
SUITE 210
NEW YORK NY 10018

Tel. 212-556-0046

Burhan Memishi - Billy Ju mirepret në:

PARAGON HONDA

55-02 Northern Blvd. Woodside, NY 11377
Ju mund te bleni makina te reja dhe te pedorura
HONDA, ACURA, MAZDA, TOYOTA
dhe plot lloje te tjera
Per informacione te tjera ne shqip ju mund te telefononi
Phone : 718-429-1500
Cell : 646-643-2854